ALBANSKA

Klasa parashkollore ekziston për fëmiun tuaj

BROSHURË MBI KLASAT PARASHKOLLORE

Skolverket

Fëmiu juaj do të fillojë të vijojë klasën parashkollore

Kjo broshurë u ofron informata mbi klasën parashkollore dhe detyrat që klasës parashkollore i janë parashtruar.

JU JENI I RËNDËSISHËM

Ju jeni personi më i afërt i fëmiut tuaj. Prandaj dhe pikëpamjet tuaja janë të rëndësishme për klasën parashkollore. Nëse tregoni mbi mendimet tuaja atëherë do të jetë më lehtë për personelin që fëmiut tuaj t'i ofrojë atë që ka nevojë.

Mirëpo për t'u inkuadruar në punën e saj dhe të ndikoni në të juve u duhet që të njohtoheni mbi atë se si funksionon klasa parashkollore.

Objektiva të përbashkëta

Rregullat mbi klasën parashkollore gjenden pjesërisht në ligjin mbi shkolla e pjesërisht në planprogramin mësimor.

Neni i nëntë i ligjit mbi shkolla bën fjalë mbi klasën parashkollore. Aty, pos tjerash, ceket se klasa parashkollore duhet të stilmulojë zhvillimin dhe mësimnxënjen si dhe të përgatit nxënësit për shkollim të mëtutjeshëm. Vijimi i klasës parashkollore është i papagesë, por edhe mund që nxënësve do t'u duhet të paguajnë shuma të vogla për shpenzime shkollore. Klasa parashkollore përbëhet prej më së paku 525 orëve mësimore dhe kryhet brenda një viti shkollor, që përbëhet nga një gjysmëvjetor vjeshtor dhe një gjysmëvjetor pranveror.

PLANPROGRAMI MËSIMOR

Qeveria ka përpiluar një planprogram të ri dhe të përqëndruar për shkollën fillore, klasën parashkollore dhe shtëpinë e aktivitetetve të lira. Planprogrami mësimor ka hyrë në fuqi prej gjysmëvjetorit vjeshtor të vitit 2011.

Shkolla speciale dhe shkolla same kanë planprogramet e tyre të veta, që në përgjithësi nuk dallojnë shumë nga ai i shkollës fillore. Fëmijët duhet të vijojnë klasin parashkollor edhe pranë shkollave speciale dhe shkollave same.

Edhe shkolla fillore speciale ka një planprogram të vetin mësimor por që kryesisht nuk dallon prej atij të shkollës fillore. Planprogrami i shkollës fillore speciale ndërkaq nuk përfshin edhe klasën parashkollore.

Dy pjesët e para – Vlerat themelore dhe detyrat e shkollës dhe Objektiva të përgjithshme dhe orientime – vlejnë për klasën parashkollore dhe shtëpinë e aktiviteteve të lira. Pjesa e tretë e planprogramit mësimor – Plane kursesh për lëndët mësimore – ndërkaq nuk vlen për parashkollën dhe shtëpinë e aktiviteteve të lira sepse vijimi në to nuk përbëhet nga lekcione dhe ligjërim të lëndëve mësimore. Në dy pjesët e para të planprogramit mësimor ju mund të mësoni se çka pritet prej juve dhe cilat janë kërkesat që u parashtrohen në klasën parashkollore. Të gjitha klasët parashkollore duhet t'i përmbahen planprogramit mësimor.

TË DREJTAT E VIJIMIT TË KLASËS PARASHKOLLORE

Të gjithë fëmijët në Suedi kanë të drejtë të vijojnë klasën parashkollore duke filluar prej gjysmëvjetorin vjeshtor kur ata të kenë mbushur gjashtë vjet. Komuna në të cilin banoni ka për obligim t'i ofrojë fëmiut tuaj një vend në klasën parashkollore. Për ju dhe fëmiun tuaj vijimi në klasën parashkollore është ndërkaq vullnetar. Fëmijët mund të pranohen në klasën parashkollore edhe pa i mbushur gjashtë vjet, e kjo është një mundësi për fillim të përshtatur. Vijimi i parashkollës prandaj nuk është i obliguar.

Klasët parashkollore janë komunale, shtetërore dhe të pavarura. Përgjegjësinë për klasët komunale parashkollore e mban një komision i zgjedhur politik. Përgjegjësinë për klasët e pavarura parashkollore e mban një udhëheqësi. Klasët parashkollor pranë shkollave speciale dhe shkollave same janë shtetërore.

Hap pas hapi deri te mësime për tërë jetën

Në klasët parashkollore mund që mënyrat dhe metodika e punës së shkollës dhe parashkollës të kombinohen. Kjo dhe është njëra prej synimeve të klasës parashkollore dhe kjo i jep parashkollës një identitet të veçantë. Këtu këto dy veprimtari, me ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet tyre, do të takohen dhe shndërrohen në një të tretë – një veprimtari që nga perspektiva e fëmiut përmban gjërat më të mira prej dy botërave. Mund të thuhet se klasa parashkollore është një urë ndërmjet parashkollës dhe shkollës.

Klasa parashkollore duhet të ngritet në themele të demokracisë. Në pjesën më të madhe të kësaj veprimtarie personeli duhet të krijojë një atmosferë të hapur demokratike ku secili nxënës përjeton vlerën e tij dhe të të tjerëve.

Klasa parashkollore duhet të stimulojë zhvillimin dhe mësimnxënjen e të gjithë nxënësve dhe t'i përgadis ata për shkollim të mëtutjeshëm si dhe të nxisë një zhvillim harmonik të tyre. Loja, krijimi dhe hulumtimi janë pjesë të rëndësishme të shkollimit dhe vullneti e kurreshtja e nxënësve poashtu do të merret parasysh. Pikënisje do të jetë që zhvillimi dhe mësimnxënia të bëhet pandërprerë dhe në të gjitha rrethanat.

Shkollimi në klasin parashkollor duhet t'u japë nxënësve mundësi të zhvillohen në drejtim të objektivave të përcaktuara në pjesën e dytë të planprogramit mësimor. Këto objektiva vlejnë për tërë shkollën fillore prandaj dhe nuk mund të realizohen menjëherë pasi të ketë mbaruar klasi parashkollor, porse veprimtaria në parashkollë mundet në shumë mënyra të kontribuojë që nxënësit të orientohen në drejtim të arritjes së atyre zhvillimeve. Disa shembuj të objektivave të tilla për secilin nxënës pasi të ketë mbaruar shkollën fillore janë:

- respektimi i vlerës së vetvetishme për secilin njeri,
- të mund të përdorë gjuhën suedeze si me shkrim ashtu edhe me gojë në një mënyrë të pasur dhe të nuancuar,
- të zotëroj të menduar matematik për shkollim të mëtutjeshëm dhe për jetën e përditshme, dhe
- që personalisht të mbaj përgjegjësinë mbi studimet dhe ambientin e punës.

Çdo klasë parashkollore është unike

Planprogrami mësimor duhet të garantojë që të gjithë nxënësve do t'u ofrohet shkollim i barabartë në klasën parashkollore, pavarësisht se ku jetojnë. Porse mënyra e punës mund të dallojë në klasë të ndryshme parashkollore. Gjëra që i përshtaten një klase parashkollore nuk i përgjegjen ndoshta një tjetre. Veprimtaria do të përshtatet në përputhje me nxënës dhe asnjë grup nxënësish nuk është krejtësisht i njëjtë me një tjetër.

Komuna, shteti ose udhëheqësia e ndonjë klase parashkolle të pavarur mbajnë përgjegjësinë kryesore mbi klasën parashkollore. Ju mund t'u drejtoheni atyre nëse lind ndonjë problem që ju dhe personeli apo drejtori nuk mund t'a zgjedhni.

Bashkëpunimi me shtëpinë

Në planprogramin mësimor thuhet që mësuesit e klasëve parashkollor mbajnë përgjegjësinë për të bashkëvepruar dhe informuar vazhdimisht mbi situatën shkollore të fëmiut tuaj, sa i pëlqen fëmiut shkolla dhe zhvillimet e tyre të njohurive si dhe t'u informojnë mbi situatën personale të fëmiut tuaj.

Kjo mund të bëhet në shumë mënyra të ndryshme; nëpërmjet letrave javore, takimit me prindër e tjera por edhe duke u ofruar mundësi për të biseduar për çdo ditë. Ju çdoherë keni mundësi të kërkoni informata ose në ndonjë mënyrë tjetër të tregoni interesimin tuaj mbi veprimtarinë e fëmiut dhe të klasit parashkollor. Ju poashtu mund të tregoni nëse ka ndodhur diç e posaçme që mund të jetë e rëndësishme e që personeli duhet ta dijë.

Sipas ligjit për shkolla ju, fëmiu juaj dhe mësuesi i fëmiut tuaj duhet që së paku një herë në vitin shkollor të takoheni për bisedë mbi zhvillimin dhe mësimnxënien e fëmiut tuaj. Planprogrami mësimor duhet të ofrojë mbështetje për këtë bisedë.

Vill du läsa hela läroplanen?

Läroplanen bör finnas i alla förskoleklasser. Du kan beställa eller ladda ned läroplanen på Skolverkets webbplats www.skolverket.se

ISBN: 978-91-87115-42-4
Grafisk form: AB Typoform
Omslagsfoto: Fotograf Michael McLain
Foto inlaga: Fotograf Michael McLain
Skolverket 2012

Skolverket